

# Njoftim për pagën minimale dhe maksimale nga periudha Janar 2021

Të nderuar tatimpagues!

Ju bëjmë me dije se, duke filluar nga **periudha Janar 2021**, paga bazë minimale mujore, në shkallë vendi për punonjësit, e detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo person juridik apo fizik, vendas apo i huaj, është 30,000 lekë. (VKM nr.1025, datë 16.12.2020)

**Për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore**, paga bruto mujore, do të jetë:

1. Jo më pak se sa paga minimale mujore, e barabartë me **30,000**(tridhjetë mijë) lekë dhe deri në **132,312** (njëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë, për personat e punësuar;
2. Jo më pak se paga minimale, e barabartë me **30,000**(tridhjetë mijë) lekë dhe sipas përcaktimit të vetë personit, deri në **132,312** (njëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë, për personat e vetëpunësuar;
3. E barabartë me pagën minimale mujore prej **30,000**(tridhjetë mijë) lekë, për punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuari punon e bashkëjeton ligjërisht.

Gjithashtu, **për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimit shëndetësor**, paga mujore do të jetë:

1. Jo më pak se sa paga minimale mujore në shkallë vendi, prej **30.000**(tridhjetë mijë) lekë dhe deri në shumën e pagës bruto, sipas deklaratës së listëpagesës, për personat e punësuar;
2. Sa dyfishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për personat e vetëpunësuar dhe punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuari punon e bashkëjeton.